



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti i mbledhjes së 162 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 163 dhe 164 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, si në vijim:
 - 1.1. Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2023:
 - 1.1.1. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës (MFPT), afati i miratimit: 29.12.2023;
 - 1.1.2. Projektligji për Inspektoratin Qendror të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Pylltarisë (MBPZhR), afati i miratimit: 15.12.2023.
 - 1.2. Ndryshohet afati për miratim në Qeveri i projektligjeve të cilat janë pjesë e Programit Legjislativ për vitin 2023, si në vijim:
 - 1.2.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (ZKM), afati i miratimit: 20.12.2023;
 - 1.2.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë (ZKM), afati i miratimit: 20.12.2023;
 - 1.2.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-023 për Personat e Zhdukur (ZKM), afati i miratimit: 20.12.2023;
 - 1.2.4. Projektligjin për Hetimin e Aksidenteve (ZKM), afati i miratimit: 20.12.2023;
 - 1.2.5. Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (ZKM), afati i miratimit: 20.12.2023;
 - 1.2.6. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të veçanta që kanë të bëjnë me krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ministrat (ZKM), afati i miratimit: 20.12.2023;
 - 1.2.7. Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-51 për Veprimtarinë Botuese dhe Librin (MKRS), afati i miratimit: 29.12.2023;
 - 1.2.8. Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore (MKRS), afati i miratimit: 29.12.2023;
 - 1.2.9. Projektligji për Sport (MKRS), afati i miratimit: 29.12.2023;
 - 1.2.10. Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (MFPT), afati i miratimit: 29.12.2023;

- 1.2.11. Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale (MFPT), afati i miratimit: 29.12.2023;
 - 1.2.12. Projektligji për Shëndetin Mendor (MSh), afati i miratimit:15.12.2023;
 - 1.2.13. Projektligji për Gjykatën Administrative (MD), afati i miratimit 29.12.2023;
 - 1.2.14. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L/010 për Noterinë (MD), afati i miratimit: 29.12.2023;
 - 1.2.15. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punës (MFPT), afati i Miratimit: 29.12.2023;
 - 1.2.16. Projektligji për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (MAPL), afati i Miratimit: 15.12.2023;
 - 1.2.17. Projektligji për Energjinë (ME), afati i miratimit 29.12.2023;
 - 1.2.18. Projektligji për Energjinë Elektrike (ME), afati i miratimit 29.12.2023;
 - 1.2.19. Projektligji për Rregullatorin e Energjisë (ME), afati i miratimit 29.12.2023;
 - 1.2.20. Projektligji për Eficiencen e Energjisë (ME), afati i miratimit 29.12.2023.
- 1.3. Barten nga Programi Legjislativ i vitit 2023 për në Programin Legjislativ për vitin 2024, projektligjet si në vijim:
- 1.3.1. Projektligji për Prokurimin Publik (MFPT);
 - 1.3.2. Projektligji për Partneritetin Publiko-Privat (MFPT);
 - 1.3.3. Projektligji për Skemën e Ndihmës Sociale (MFPT);
 - 1.3.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (MFPT);
 - 1.3.5. Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (MFPT);
 - 1.3.6. Projektligji për Shëndetësi (MSh);
 - 1.3.7. Projektligji për Sigurime Shëndetësore (MSh);
 - 1.3.8. Projektligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale (MSh);
 - 1.3.9. Projektligji për Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë (MSh);
 - 1.3.10. Projektligji për Tokën Bujqësore (MBPZhr);
 - 1.3.11. Projektligji për Veterinarinë (MBPZhr);
 - 1.3.12. Projektligji për Oden Ekonomike (MINT);
 - 1.3.13. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëri Tregtare (MINT);
 - 1.3.14. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (MD);
 - 1.3.15. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat (MD);
 - 1.3.16. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (MD);
 - 1.3.17. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (MD);
 - 1.3.18. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (MD);
 - 1.3.19. Projekt Kodi Civil i Republikës së Kosovës (MD);
 - 1.3.20. Projektligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (MASHTI);
 - 1.3.21. Projektligji për Profesionet e Rregulluara (MASHTI).
- 1.4. Tërhiqet nga Programi Legjislativ për vitit 2023, Projektligji si në vijim:
- 1.4.1. Projektligji për Turizmin Rural (MBPZhr);
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Mbrojtje nga Zjarri.
1. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Kompensimit Përfshirë edhe Llogaritjen e Kompensimit për Dëmtimet e Shumëfishta.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËA 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në Marrëveshjen Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Drejtues për mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit "Instrumenti për Barazinë Gjinore" (Gender Equality Facility) në kuadër të programit IPA 2021, në përbërje të:
 - 1.1. Edi Gusia, Zëvendësuese e Drejtoreshës Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit - kryesuese;
 - 1.2. Florim Canolli, Drejtor i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim, Zyra e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.3. Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtar;
 - 1.4. Vedat Sagonjeva, Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministrit - anëtar.
2. Me qëllim të zbatimit të pikës 1. të këtij Vendimi dhe për të qenë pjesë e këtij Komiteti Drejtues ftohen për të dërguar përfaqësuesit e tyre:
 - 2.1. Zyra e BE-së në Kosovë;
 - 2.2. UN Women në Kosovë.
3. Kryesuesja, varësisht nga temat e rendit të ditës, do të ftojë përfaqësuesit e institucioneve të tjera publike të Republikës së Kosovës dhe të organizatave të shoqërisë civile, për të marrë pjesë në punimet e Komitetit Drejtues me qëllim të koordinimit dhe konsultimit ndër-institucional, të nevojshëm për zbatimin e Projektit.
4. Komiteti Drejtues ka për detyrë kryesore mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Projektit, sikurse parashihet në Marrëveshjen Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2021 dhe në aktet zbatuese të marrëveshjes si dhe konsultimin dhe koordinimin e vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike të Republikës së Kosovës me BE-në për realizimin e detyrimeve të përbashkëta në lidhje me Projektin.
5. Detyrat të tjera të Komitetit Drejtues përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 5.1. Ofrimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve sa i përket orientimit strategjik dhe dhe zbatimit të projektit në fjalët;
 - 5.2. Shqyrtimin dhe miratimin e Planit Vjetor të Punës;
 - 5.3. Shqyrtimin dhe miratimin e Raportit Narrativ Vjetor dhe Planit Vjetor të Punës për periudhën e ardhshme;

- 5.4. Shqyrtimin e ndryshimeve të aktiviteteve që ndikojnë mbi rezultatet;
 - 5.5. Sigurimin e koordinimit me institucionet e tjera me qëllim të zbatimit të projektit si dhe avancimin e përgjithshëm të çështjeve gjinore në të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.
6. Komiteti Drejtues mund të bëjë monitorimin shtesë të zbatimit të aktiviteteve të Projektit nëpërmjet stafit të Agjencisë për Barazi Gjinore si dhe sipas kërkesave të tjera të përcaktuara në Marrëveshjen Financiare dhe akteve zbatuese të marrëveshjes.
 7. Komiteti Drejtues dakordon me shkrim rregullat e punës dhe i shpërndan te të gjithë anëtarët e tij si dhe te të ftuarit e tjerë sipas rastit.
 8. UN Women në Kosovë do të ofrojë përkrahje administrative dhe teknike për Komitetin Drejtues, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës, materialeve të takimit, minutave të takimit.
 9. Komiteti Drejtues takohet së paku 2 (dy) herë në vit.
 10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërlidhur me nenin 99 paragrafi 6. të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 14 të Rregullores Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Bislim Bislimi, emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë 4 (katër) vite.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/16 të datës 28 dhjetor.2022

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/16 të datës 28 dhjetor 2022, për themelimin e Mekanizimit ndërinstitucional për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin dhe kontrollin e Qenëve me dhe pa Pronar në Republikën e Kosovës, përkatësisht Vendimit i shtohen edhe 2 (dy) përfaqësues:
 - Përfaqësues nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë i Universitetit të Prishtinës;
 - Përfaqësues nga Shoqata për Mbrojtjen e Kafshëve "Šapa".
2. Ndryshohet dhe plotësohet Pika 1.5 e Vendimit Nr. 12/16 të datës 28 dhjetor 2022 "Koalicioni Ndërkombëtar për Menaxhimin e Kafshëve Shoqëruese (ICAM)" zëvendësohet me "Four Paws International.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Nr. 12/16 të datës 28 dhjetor 2022.
4. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 paragrafi 1,2. dhe 3. të Ligjit Nr. 08/L-037 për Pyjet, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për dhënien në shfrytëzim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite të Pronave të kërkuara nga Komuna e Dragashit të menaxhuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës, përkatësisht të parcelës P-706040037-01385-0, me sipërfaqe 13568m², ZK Restelicë në vendin e quajtur PRISOJE-PRISOJE, pjesa e parcelës që do të shfrytëzohet është 293 m².
2. Përfituesi i së drejtës së shfrytëzimit në afat prej 15 viteve, të ngastrës P-706040037-01385-0, sipërfaqe 13568m², ZK Restelicë në vendin e quajtur PRISOJE-PRISOJE, është Komuna e Dragashit, prona do të shfrytëzohet për ndërtimin e deponisë pikës grumbulluese të mbeturinave komunale, për nevojat e qytetareve të fshatit Restelicë. Pjesa e parcelës që do të shfrytëzohet është 293 m².
3. E drejta e shfrytëzimit sipas nenit 1. të këtij Vendimi bëhet për ndërtimin e deponisë, pikës grumbulluese të mbeturinave komunale, për nevojat e qytetareve të fshatit Restelicë.
4. Ngastrat me të dhënat e paraqitura konform kërkesës së Komunës së Dragashit, regjistrohen si shfrytëzues në emër të Komunës së Dragashit.
5. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia për Menaxhimin e Pyjeve të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr.06/153 të datës 26 korrik 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi Përfundimtar Nr.06/153 i datës 26 korrik 2023 si vijon:
 - 1.1. Pika 7. e Vendimit Përfundimtar riformulohet si në vijim: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportin e vlerësimit komfor legjislacionit në fuqi dhe Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
2. Ky Vendim është pjesë e Vendimit të Qeverisë Nr.06/153 të datës 26 korrik 2023.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Mbrojtja dhe Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore, Konservimi dhe Investimi në "Lokalitetin Arkeologjik të Dresnikut" pjesë e trashëgimisë në mbrojtje të përhershme (Nr. unik TKRKS2A005), Zona Kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh "Juogopetroll" parcela kadastrale Nr. 1817-0 dhe Objektin që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, i cili gjendet në parcelën Nr. 1318-1 në pronësi të Komunës së Rahovecit, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit" Zona Kadastrale: Rahovec, Komuna Rahovec, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Rahovecit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/172
Datë: 08.11.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i 4 (katër) projekteve si më poshtë:
 - Rikonstruktimi dhe zgjerimi i "Deponisë Sanitare" ekzistuese në Landovicë për regjionin e Prizrenit, Zona Kadastrale: Landovicë, Komuna Prizren;
 - Rikonstruktimi dhe zgjerimi i "Deponisë Sanitare" ekzistuese në Velekincë, për regjionin e Gjilanit, Zonat Kadastrale: Velekincë dhe Uglarë, Komuna Gjilan;
 - Ndërtimi "Deponisë së re Sanitare", për regjionin e Prishtinës, Zonat Kadastrale: Puturoc, Ribari i Madh dhe Qylagë, Komuna Lipjan; dhe
 - Rehabilitimi, mbyllja dhe ndërtimi i stacionit të transferit i "Deponisë Sanitare" në Dumnicë e Poshtme, për regjionin e Podujevës, Zona Kadastrale: Dumnicë e Poshtme, Komuna Podujevë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Ekonomisë dhe Komunitat Prizren, Gjilan, Lipjan dhe Podujevë.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PER 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. KBI "Progres" e cila është e nevojshme për realizimin e Projektit: "Varrezat e Qytetit të Prizrenit" Zona Kadastrale: Landovicë, Komuna Prizren, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Prizrenit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR [Signature]
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme të ish shoqërore N. Sh. O.B "Sharrprodhimi", parcela kadastrale Nr.1048-3 në Objektivin që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, për realizimin e Projektit "Ndërtimi i Zonës së Gjelbër - Parkut Publik për nevoja të Komunitetit", Zona Kadastrale Bresanë, Komuna Dragash, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komuna e Dragashit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Traktatit për Ekstradim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave komfor dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për [signature]
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut lidhur me Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim "KSV/021: Shkathtësitë për Punë të Qëndrueshme në Kosovë".
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndërmarrjen e hapave komfor dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Pën

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut lidhur me Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim "KSV/023: Rritja e Qëndrueshme dhe Gjithëpërfshirëse në Kosovë".
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave komfor dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËN
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes "KSV/024: Tranzicioni i Energjisë dhe Zbutja e Klimës në Kosovë" ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madhe të Luksemburgut.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Ekonomisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës në Programin e Unionit "Programi i Evropës Digjitale për periudhën 2021-2027" ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Bashkimit Evropian.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministres së Ekonomisë për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PER

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/172
Datë: 08.11.2023

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin "Banimi Social Adekuat".
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë